

L ë n d a: Mbledhja e Komisionit Kombëtar të Nomenklaturave

KKN

Minutat e takimit

Datë 28.05.2021

Më datë 28 Maj u zhvillua mbledhja ad-hoc e Komisionit Kombëtar për Nomenklaturat për miratimin e Rregullores GEONOM (Nomenklatura e Shteteve dhe Territoreve për Statistikat e Tregtisë së Jashtme të Mallrave dhe Ndarjen Gjeografike për Statistikat e tjera të Biznesit).

Në mbledhjen online ishin 15 anëtarë të KKN.

Takimi u hap nga Zv.Kryetarja Znj. Rahela Reçi duke i bërë me dije anëtarët që Kryetarja e KKN, znj. Elsa Dhuli do të bashkohet së shpejti në takim. Pas miratimit të axhendës nga të gjithë anëtarët mbledhja vijoi sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i nomenklaturës GEONOM për propozim në KM.

Anëtarja e KKN, përfaqësuese e INSTAT, Znj. Flutura Rama theksoi rëndësinë e miratimit dhe zbatimit të klasifikimit GEONOM, si pjesë e PKIE 2021-2023. INSTAT, në rolin e liderit të Sistemit Kombëtar Statistikor, ka vendosur si objektivi: miratimin e këtij klasifikimi brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2021.

Anëtarëve të KKN iu është vënë në dispozicion në versionin Anglisht-Shqip Rregullorja e Komisionit Evropian Nr. 2020/1470, datë 12.10.2020 “Mbi Nomenklaturën e Shteteve dhe Territoreve për Statistikat Evropiane për Tregtinë Ndërkombëtare të Mallrave dhe Ndarjen Gjeografike për Statistikat e Tjera të Biznesit së bashku me përmbajtjen e klasifikimit.

Klasifikimi që do të miratohet në këtë takim është dokumenti final, ku janë pasqyruar sugjerimet e të gjithë anëtarëve të KKN.

Më pas u procedua me votimin online, ku të gjithë anëtarët e pranishëm në takim **miratuam klasifikimin Geonom.**